

RELACION

Mbi

RAPORTIN E MONITORIMI TË VITIT 2020

Për vitin 2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë administroi dhe menaxhoi fondet buxhetore sipas 11 programeve:

- Planifikim, Menaxhim, Administrim
- Transporti Rrugor
- Transporti Detar
- Transporti Hekurudhor
- Transporti Ajror
- Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime
- Menaxhimi i Mbetjeve Urbane
- Mbështetje për Energjinë
- Mbështetje për Burimet Natyrore
- Mbështetje për Industrinë
- Planifikimi Urban

Plani fillestar i buxhetit në zbatim të ligjit nr.88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit në zbatim të akteve normative dhe akteve nënligjore, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Programi	Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	Diferenca
Planifikim, Menaxhim, Administrim	549.956	504.547	-45.408
Transporti Rrugor	22.559.832	28.863.204	6.303.372
Transporti Detar	155.009	145.075	-9.934
Transporti Hekurudhor	1.789.400	759.456	1.029.944
Transporti Ajror	55.200	55.200	-
Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	8.754.711	12.620.153	3.865.442
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	3.492.272	3.653.272	161.000
Mbështetje për Energjinë	2.590.900	2.375.900	-215.000
Mbështetje për Burimet Natyrore	204.000	263.778	59.778
Mbështetje për Industrinë	379.150	376.616	- 2.534
Planifikimi Urban	329.100	392.184	63.084
TOTALI	40.859.530	50.009.385	9.149.855

Të dhënat e raportuara të buxhetit fillestar dhe me ndryshime përkojnë plotësisht me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ. Diferencat lidhen me ndryshimet që pësoi buxheti gjatë zbatimit të tij me akte normative, transferime dhe rialokime të fondeve buxhetore dhe si rezultat i detajimit të fondit të veçantë prej 3.500.000 lekë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2020, i ka realizuar shpenzimet e buxhetit, krahasuar me planin e rishikuar prej rreth 88.5 %.

Konkretisht sipas programeve % e realizimit paraqitet si më poshtë:

Kod. Prog.	Programi	% e Realizimit Buxhetit Rishikuar
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	98
04520	Transporti Rrugor	100
04540	Transporti Detar	91
04550	Transporti Hekurudhor	79
04560	Transporti Ajror	79
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	88
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	96
04320	Mbështetje për Energjinë	82
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	97
04440	Mbështetje për Industrinë	95
06180	Planifikimi Urban	66

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, realizimi në % paraqitet si më poshtë:

Kod. Prog.	Programi	Shpenzime Korrente (në %)	Shpenzime Kapitale (në %)
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	98	62
04520	Transporti Rrugor	85	101
04540	Transporti Detar	88	100
04550	Transporti Hekurudhor	98	56
04560	Transporti Ajror	45	99
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	98	87
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	100	95
04320	Mbështetje për Energjinë	20	84
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	97	98
04440	Mbështetje për Industrinë	99	82
06180	Planifikimi Urban	98	37

Sqarojmë se në realizimin e ulët të disa shpenzimeve buxhetore për vitin 2020 ka ndikuar situata lidhur me pandeminë COVID 19.

Performanca dhe realizimi i produkteve sipas programeve buxhetore

Programi “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Në këtë program planifikohen, detajohen, monitoron dhe menaxhon fondet buxhetore, të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit, me qëllim realizimin e qëllimit dhe arritjen e objektivave të politikës së programit, për funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Aparatit të Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, rritjen e standardeve dhe performancës së punës të institucionit.

Në vitin 2020, janë miratuar 163 akte ligjore dhe nënligjore, nga të cilat vetëm 36 prej tyre ishin të parashikuara në PPAP 2020.

Janë realizuar gjithsej 15 angazhime auditimi, nga të cilat 5 auditime të kombinuara, 6 auditime financiare dhe 4 auditimi të përputhshmërisë, nga të cilat 2 të iniciuara nga titullari. Për këtë periudhë, sipas planit vjetor të miratuar u planifikuan dhe u realizuan 15 misione auditimi.

SHPENZIMET KORRENTE

- *Paga dhe sigurime*, plani i rishikuar i vitit 2020 prej 292.9 milion lekë është realizuar në vlerën 285.7 milion lekë ose 98%.
- *Shpenzime operative*, plani i rishikuar i vitit 2020 prej 127.4 milion lekë është realizuar në vlerën 124.3 milion lekë ose 98%.
- *Transfertat korrente të huaja*, plani i rishikuar 2020 prej 28 milion lekë është realizuar në vlerën 28 milion lekë ose 100% me të cilat u kryen pagesat për 6 institucione ndërkombëtare ky Shqipëria aderon në sektorët që MIE ka nën administrim.
- *Transfertat për Buxhetin Familjar dhe Individual*, plani i rishikuar 2020 prej 53.6 milion lekë është realizuar në vlerën 53.5 milion lekë ose 100%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENSHËM

- Projekti asistencë teknike "Zhvillimi infrastrukturës digjitale rajonale" është planifikuar në vlerën 2.59 milion është realizuar në vlerën 1.6 milion lekë, ose në masën 62%.

Programi “TRANSPORTI RRUGOR”

Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit, programi i transportit rrugor synon:

- ✓ Të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit;
- ✓ Të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë, ndërlihdjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;

- ✓ Programi synon mbulimin me financim dhe zgjerimin, rritjen e standardeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm

SHPENZIMET KORRENTE

Realizimi sipas zërave buxhetore paraqitet si më poshtë :

- Fondi vjetor i *pagave*, plani 141,134,000 lekë dhe realizimi financiar 135,715,000 lekë, ose 97 %.
- Fondi vjetor i *sigurimeve shoqërore*, plani 22,107,000 lekë dhe realizimi financiar 21,608,000 lekë ose 98%.
- Fondi vjetor i *shpenzimeve operative*, plani 1,336,259,000 lekë dhe realizimi financiar 1,124,154 lekë, ose 85%.

Për vitin 2020, Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka raportuar se janë krijuar detyrime të prapambetura në zërin e shpenzimeve korrente, në kontratat e mirëmbajtjes rrugore dhe deri në datën 31.12.2020, janë 244,342,922 lekë, detyrime si më poshtë :

1. Autoriteti Rrugor Shqiptar, detyrime në vlerën 74,171,272 lekë.
2. Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, detyrime në vlerën 107,707,919 lekë.
3. Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë, detyrime në vlerën 62,463,731 lekë.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Gjatë vitit 2020, buxheti i investimeve me financim të brendshëm, pësoi disa herë ndryshime të cilat erdhën nga miratimi dhe zbatimi i akteve ligjore si më poshtë:

- VKM nr.463, datë 10.06.2020, për projektin "Shpronësimi i pronarëve në segmentin rrugor Pallati me Shigjeta – Rreth Rrotullimi Shqiponja", buxheti u shtua në vlerën 200,000,000 lekë.
- VKM nr.464, datë 10.06.2020, për projektin "Studim fizibiliteti për Tunelin e Llogarasë", buxheti u shtua në vlerën 150,000,000 lekë.
- Akti Normativ nr.28, datë 02.07.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në buxhetin e vitit 2020", buxheti u shtua në vlerën 7,196,336,000 lekë.
- VKM nr.525, datë 24.07.2020, për projektin "Ndërtimi i Urës së Tapizës", buxheti u shtua në vlerën 151,539,896 lekë.
- VKM nr.610, datë 29.07.2020 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)", buxheti u pakësua me 140,000,000 lekë.
- Akti Normativ nr.34, datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në buxhetin e vitit 2020", buxheti u pakësua me 2,606,000,000 lekë.

Në buxhetin e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, janë financuar projektet e kontratave koncesionare, ku plani i vjetor i rishikuar i buxhetit për vitin 2020, për projektet koncesionare, është në vlerën 3,504,869,000 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 3,467,484,448 lekë ose 99 % e realizuar.

Për projektet me financim të brendshëm që zbatohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar edhe gjatë vitit 2020, ka vazhduar implementimi në projektet e infrastrukturës rrugore, sipas kontratave dhe

grafikut të punimeve. Nga të dhënat "Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve", rezulton se:

Grupi i produktit "Ndërtim Rruge" i shprehur në sasi (km) për vitin 2020 është parashikuar 16.56 km dhe është realizuar 16,55 km. Për këtë produkt u planifikuan 10,731,024,000 lekë dhe realizimi është 10,386,141,000 lekë ose 99,8 % e planit e realizuar.

Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tipeve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1' me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), janë planifikuar për vitin 2020 konkretisht:

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
A2 me standartet e reja - 0.40 km	0,44 km ose 100% e planit
A e modifikuar - 0.75 km	0.75 km ose 100% e planit
A2' - 5.9 km	5.9 km ose 100 % e planit
B1' - 5.81 km	5.8 km ose 99.8 % e planit
C2 - 3.7 km	3.7 km ose 100 % e planit

Grupi i produktit "Rikonstruksion Rruge" i shprehur në sasi (km) për vitin 2020, është parashikuar 1,24 km dhe është realizuar 1,24 km ose 100% e shpenzimeve faktike për këtë produkt. Shpenzimet e këtij grupi janë planifikuar për financimin e rrugëve Tip C2 me dy korsi. Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tipeve për rikonstruksionin e rrugëve tip C2, janë konkretisht:

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
C2 - 1.24 km	1.24 km ose 100 % e planit

Ndërtim rruge tip A2 me katër korsi (2x2)

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 242,222,000 lekë (2.3 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim rruge"). Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është në vlerën 242,218,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar.

Përfshihen në këtë grup rrugë me katër korsi dhe gjerësi 20-25 m, me objektin "Vendosja e mbikalimeve në aksin rrugor Thumanë - Milot dhe Kukës – Morinë".

Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2) sipas standarteve të reja

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 1,365,904,000 lekë (13.1 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 0.40 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është në vlerën 1,365,889,000 lekë ose 100% e buxhetit e realizuar. Përfshihen në këtë grup rruge:

- Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3;
- Ndërtim rruga mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të tij;
- Studim Projektim mbikalimi TEG;
- Studim-projektim, rishikim i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të unazës së madhe Tiranë nga sheshi Shqiponja - Bulevardi i ri;

Ndërtim rruge tip A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 2,899,143,000 lekë (28 % ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 3.99 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 2,899,142,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar dhe në km janë realizuar 5.9 km ose 100% e sasisë së planifikuar.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsi dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si:

- Përfundim i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit;
- Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 2, Loti 3;
- Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2 , Loti 3;
- Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh dhe Loti 2;

Ndërtim rruge tip B1' me dy korsi

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 3,238,434,000 lekë (31.2% ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 5.81 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 3,221,369,000 lekë ose 99.5% e buxhetit të planifikuar dhe në km janë realizuar 5.8 km ose 99.8% e sasisë së planifikuar.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur projektin ku po punohet me ritme të parashikuara "Ndërtim Rruga Kardhiq - Delvinë Loti 4, Loti 5, Loti 6".

Ndërtim rruge tip C2 me dy korsi

Për tipin e rrugës C2 janë planifikuar fonde në vlerën 2,470,416,000 lekë ose 23.8% ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 3.7 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është në vlerën 2,470,409,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar dhe në sasi 3.7 km ose 100 % e sasisë së planifikuar.

Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m.

Po punohet normalisht në objektet që janë në proces:

- Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1 dhe shtesë punimesh;
- Ndërtim rruga Korçë – Ersekë, Loti 2 (pjesa e parë);
- Ndërtim mure mbajtës dhe pritës në segmentin rrugor Kuben – Vasije;
- Stabilizim i rrëshqitjeve në segmentin rrugor Milot - Rrëshen, rruga e vjetër;
- Ndërtim tombino dhe kanali, në aksin rrugor Tiranë - Elbasan (aksi i vjetër) dhe ndërtim tombino në aksin rrugor Uzina traktori – Lanabregas;
- Largimi i inerteve të rrugës provizore dhe kthimi i bregut të liqenit në gjendjen e mëparshme në aksin Lin – Pogradec.

Ndërtim rruge A e modifikuar

Ky tip rruge përfaqëson një aks rrugor autostradë me katër vija kalimi 4x3.75 dhe me dy bankina të asfaltuara me gjerësi 2x3 m, si dhe dy bankina të pa asfaltuara me gjerësi 2x1.5 m, së bashku dhe me trafik ndarësen e mesit (NeëJersey) gjerësia e trupit të rrugës është 28 m. Për tipin e rrugës A e modifikuar janë planifikuar fonde në vlerën 170,022,000 lekë ose 1.6 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge" dhe në sasi 0.75 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës A e modifikuar është në vlerën 170,022,000 lekë ose në sasi është 0.75 km, ose 100% e realizuar. Konkretisht objekti "Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3".

Rikonstruksion rruge tip C2 me dy kors

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 184,544,000 lekë (100% ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Rikonstruksion Rruge") dhe në sasi 1.24 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 184,544,000 lekë ose 100% e buxhetit e realizuar për Grupin e produktit "Rikonstruksion Rruge".

Përfshihen kryesisht (Sistemim Asfaltim) rruge me gjërësi deri 8.5 metra tip C2 dhe janë në proces ndërtimi si - Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Elbasan- Banjë, Loti 3+ shtesë punimesh.

Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 589,352,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Sinjalistikë rrugore") dhe në sasi 512.5 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 589,246,000 lekë ose 100% ndaj planit vjetor dhe janë realizuar 512.5 km.

Këtu përfshihen projektet:

- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1, vazhdimi;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendror, Loti 2;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3, vazhdimi;
- Punime ndërtimi për eliminimin e pikave të zeza në rrugë (bashkëfinancim IPA 2013, siguria rrugore).
- Përmirësim i sigurisë rrugore në segmentet me rrezik të lartë të rrjetit rrugor kombëtar;
- Eliminimi i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar;

Ura

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 228,907,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit ndërtim urash) dhe në sasi 0.43 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 85,459,000 lekë ose 37.3% ndaj planit vjetor dhe në km janë realizuar 0.31 km. Në këtë zë janë përfshirë dhe fondet e akorduara për Autoritetin Rrugor Shqiptar, nga Fondi i Rindërtimit në vlerën 151,539,896 lekë për rindërtimin e projektit "Rindërtimi i Urës së Tapizës" të dëmtuar nga tërmeti.

Këtu përfshihen objektet:

- Rindërtim i Urës së Tapizës
- Ndërtim i Urës së Zemblakut
- Rikonstruksion i Urës së Kaludhit
- Rikonstruksion i Urës së Dragotit
- Rikonstruksion i Urës së Leklit
- Rikonstruksion i Urës së Vorës

- Emergjence Rikonstruksion i Urës së Kirit
- Emergjencë mbrojtje lumore Ura e Drojës

Grupi i shpenzimeve për zërat shpronësime, vendime gjyqësore, i detajuar paraqiten si më poshtë:

	PLANIFIKUAR	FINANCUAR
- Vendime gjyqësore	444,197,000 lekë	444,197,000 lekë ose 100% e realizuar
- Shpronësime	2,043,538,000 lekë	2,043,538,000 lekë ose 100% e realizuar

Shpenzimet kapitale për TVSH dhe Kosto Lokale, së bashku janë planifikuar fonde në vlerën 2,043,538,000 lekë ose 100% e buxhetit ose (17.7 % ndaj planit vjetor) dhe janë financiar, si më poshtë:

- Kosto Lokale	1,175,095,000 lekë	1,169,395,000 lekë ose 100%
- TVSH e T.D	1,817,627,000 lekë	1,816,910,000 lekë ose 100%

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ

Plani i buxhetit me financim të huaj është 6,503,132 lekë dhe realizimi financiar është 7,041,941 lekë ose 108% e realizuar. Me Aktin Normativ nr.28, datë 2.07.2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, Autoritetit Rrugor Shqiptar, ju akorduan fonde buxhetore shtesë për financimin e huaj në vlerën 395,000,000 lekë dhe gjatë vitit ka vazhduar financimi dhe zbatimi i projekteve me financim të huaj si:

- Projekti i Mirëmbajtjes i Bankës Botërore
- Projekti Ndërtim By pass i Vlorës
- Projekti Ndërtim By pass i Fierit
- Projekti Ndërtim rruga Qukës–Qafë Plloçë

Në sasi në zërin ndërtim rrugësh Kategoria B, C dhe Kategori të ndryshme (Mirëmbajtja) janë planifikuar 1,358 km dhe janë realizuar 1,360 km.

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
B - 13 km	13 km ose 100 % e planit

Programi “TRANSPORTI DETAR”

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë gjatë vitit 2020 pati prioritet vazhdimësinë e kryerjes së investimeve për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale në zhvillimin e Shqipërisë nga një vend bregdetar në një vend të zhvilluar detar orientuar drejt rritjes ekonomike e integritit europian, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

SHPENZIMET KORRENTE

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për funksionimin e kësaj strukture.

Realizimi i shpenzimeve korrente (sipas klasifikimit ekonomik), paraqitet si më poshtë:

	<i>në mijë lekë</i>
- Shpenzimet për paga	67.999
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore	11.244
- Shpenzimet operative	16.269

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Investimet me financim të brendshëm, janë planifikuar në shumën 36,800,000 lekë për vitin 2020 dhe realizimi financiar është në vlerën 36,718,430 lekë ose 100%.

Sipas projekteve ai paraqitet :

- “Konservimi i ndërmarrjes së kontrollit të shfrytëzimit të mjeteve ujore Vau i Dejës” është planifikuar në vlerën 3.000.000 lekë dhe është realizuar 2.972.383 lekë ose në masën 99%, për shkak se fondet buxhetore paguhen paga dhe sigurime për punonjësit e kësaj ndërmarrje.
- “Blerje kompjutera, printera, fotokopje për DPD dhe Kapiteneritë” plani i rishikuar në vlerën 3.5 milion lekë është realizuar në masën 91% për shkak se fondet u pakësuan me Aktin normativ nr.34, datë 17.12.2020.
- “Blerje pajisje navigacionale për Kapiteneritë Durrës, Vlorë, Shëngjin, Sarandë” plani i rishikuar është planifikuar në vlerën 10.9 milion lekë dhe realizimi financiar në masën 100%.
- “Rikonstruksion i godinës së DPD” është planifikuar në vlerën 9.4 milion lekë dhe realizimi financiar në masën 100%, projekti është planifikuar të vijojë edhe në vitin 2021.
- “Rikonstruksion i kalatës së RORO” është planifikuar në vlerën 10 milion lekë dhe realizimi financiar është në masën 100%.

Programi “TRANSPORTI HEKURUDHOR”

Prioriteti kryesor në fushën e transportit hekurudhor ka qenë dhe mbetet “Reformimi i sektorit hekurudhor për të krijuar një treg të hapur për publikun dhe investitorët privatë”.

Në vijim të kësaj politike janë vendosur dhe objektivat për realizimin e të cilave është punuar për gjatë gjithë vitit ushtrimor 2020:

- ✓ Prgatitjen e akteve ligjore,
- ✓ Kompletimi i gjithë sistemit hekurudhor me studime paraprake, studime fizibiliteti dhe projekt zbatimi për ndërtim dhe rikonstruksion,

- ✓ Ruajtja e gjendjes ekzistuese të linjave hekurudhore nëpërmjet realizimit të investimeve në infrastrukturë.

SHPENZIMET KORRENTE

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture si dhe subvencioni në mbështetje të hekurudhës për Hekurudha Shqiptare sh.a.

Realizimi i shpenzimeve korrente (sipas klasifikimit ekonomik), paraqitet si më poshtë:

	<i>në mijë lekë</i>
- Shpenzimet për paga	9.177
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore	1.532
- Shpenzimet operative	2.778
- Subvencione	400.000

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Realizimi i shpenzimeve kapitale sipas produkteve, paraqitet si më poshtë:

- Produkti “Inspektime të kryera në linjat dhe mjetet hekurudhore” janë planifikuar 23.7 milion lekë dhe janë realizuar 8.835 milion lekë ose 37.2 %.
- Produkti “Përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore” janë planifikuar në vlerën 36.631.918 lekë dhe janë realizuar 16.515.174 lekë ose 40.58 %.
- Produkti “Rritja e disponibilitetit të mjeteve lëvizëse” janë planifikuar në vlerën 25.000.000 lekë por u pakësua me akt normativ duke arritur në vlerën 13.444.000 lekë.
- Produkti “Studime dhe projekte” janë planifikuar në vlerën 430.000.000 lekë dhe janë realizuar 23.899.121 mijë lekë ose 3 % e planit.

Realizimi sipas projekteve paraqitet si më poshtë:

- Projekti “Rikonstruksion i linjës Shkodër - Hani Hotit” u planifikuan 8.741.468 lekë dhe janë realizuar në masën 100% duke bërë punime në mbishtresën hekurudhore si traversa, ballast, aksesorë linje.
- Projekti “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Shkozë - Kavajë” janë planifikuar në vlerën 1.125.000 lekë si detyrim i prapambetur nga të cilat u financuan 855.121 lekë duke realizuar punime në mbishtresën hekurudhore si traversa, ballast, aksesorë linje.
- Projekti “Rikonstruksion i linjës Kavajë - Rrogozhinë” janë planifikuar në vlerën 858.000 lekë si detyrim i prapambetur dhe janë realizuar 857.033 lekë ose në masën 100%.
- Projekti “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Milot - Lezhë” janë planifikuar në vlerën 31.000 lekë dhe janë realizuar 30.375 lekë ose 100% e planit si detyrim i prapambetur per kolaudatorin.

- Projekti “Punime për mbrojtjen e linjës” janë planifikuar në vlerën 16.490.000 lekë dhe janë realizuar 16.484.798 lekë ose 100% e planit. Aktualisht është realizuar mbrojtja e trasesë nga gërryerjet e lumenjve nëpërmjet pritave lumore dhe rrëshqitjes në pikat më të dobëta përgjatë linjës hekurudhore.
- Projekti “Blerje traversa betoni” janë planifikuar në vlerën 9.544.800 lekë dhe janë realizuar në masën 100%. Me këtë investim është realizuar ndërrimi i traversave duke përmirësuar parametrat teknikë të lëvizjes.
- Projekti “Rinovim agregat për lokomotiva” janë planifikuar në vlerën 6.444.000 lekë dhe u realizuan 100% duke arritur të mbahen në gjendje pune lokomotivat.
- Projekti “Rikonstruksion i magazinave të NJSHML” janë planifikuar në vlerën 7.000.000 lekë i cili nuk u realizua pasi nuk u arrit në kohë të bëhet prokurimi.
- TVSH janë financuar në vlerën 10.483.390 lekë për objektin “Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore "Vorë - Hani i Hotit (kufi me Malin e Zi)” dhe 13.415.731 lekë për “Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë”

Programi “TRANSPORTI AJROR“

Ky program merret me hartimin e politikave zhvilluese të transportit ajror që synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe për të mundësuar gjetjen e burime të ndryshme financuese dhe investuese për infrastrukturën aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues në shërbimet ajrore.

Objektivat dhe produktet të cilat u arritën, përgjithësisht janë të lidhur me:

- ✓ zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara,
- ✓ rritjen e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të incidenteve/Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve.

SHPENZIMET KORRENTE

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Organit Kombëtar të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture.

Realizimi i shpenzimeve korrente (sipas klasifikimit ekonomik), paraqitet si më poshtë:

	<i>në mijë lekë</i>
- Shpenzimet për paga	6,624
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore	1,093
- Shpenzimet operative	1,345

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Për programin “Transporti Ajror” janë parashikuar, në total, 35 milion lekë, 34.5 milionë lekë për Aparatin e MIE, dhe 500 mijë lekë për projektet që ndjek OKIIA.

Zbatimi i projekteve për vitin 2020, paraqitet:

- “Rikonstruksion, riparim, dhe sistemim i ambienteve të OKIIA” u realizua në vlerën 456.000 lekë kundrejt fondeve të planifikuara prej 500.000 lekë, ose në masën 9%.
- “Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit, janë realizuar në vlerën 34,179,999 lekë kundrejt fondeve të planifikuara prej 34.500.000 lekë, ose në masën 99%.

Programi “FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME”

Prioriteti kryesor në këtë sektor ka qenë dhe mbetet “Reforma në sektorin Ujësjiellës Kanalizime” me objektiv:

- Mbështetje, nxitje e Qeverisë Vendore: përmirësim i shërbimit, qëndrueshmëri, rritje e aksesit me ujë të pijshëm, grumbullimin e ujërave të zeza dhe trajtimin e tyre, me fokus të veçantë zonat bregdetare, furnizimi me ujë 24 orë, reduktimi i humbjeve.

- Mirëqeverisja

- *Ligji sektorial*

Përfunduar drafti final i Projekt-ligjit për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin, Grumbullimin e Trajtimin e Ujrave të Ndotura Urbane

- *Strategjia sektoriale*

Përfunduar drafti final i Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030 dhe konsultimi me grupet e interes

- *Kontratat e performancës*

- Programi kombëtar i trajnimit & certifikimit

- Mirëmenaxhimi i aseteve

- Ngritur platforma për regjistrimin dhe menaxhimin online, në kohë reale të aseteve të sha UK
- Përfunduar 12 Bashkitë ku po pilotohet: Saranda, Shkodra, Cerrik, Peqin, Vlora, Berat, Kavaja, Durrësi, Himara, Elbasan, Permet, Gramsh

- INFRASTRUKTURA

- Furnizimi me Ujë, Nivel Kombëtar 15.1 (orë/ditë)
- Furnizimi me Ujë, Zona Urbane 18 (orë/ditë)
- Mbulimi i Popullatës, Nivel Kombëtar 81.5 (% Ujëmatësa)
- Mbulimi i Popullatës, Zona Urbane 79.7 (% Ujëmatësa)
- Mbulimi i plotë dhe me cilësi me shërbim të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive UK
- Investime për arritjen e furnizimit me ujë 24 orë/ditë në qendrat urbane të bashkive (Delvinë, Durrës, Gramsh, Këlcyrë, Krujë, Fushë-Krujë, Malësi e Madhe, Patos, Ura Vajgurore, Vau i Dejës)

SHPENZIMET KORRENTE

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Agjencisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për funksionimin e kësaj strukture.

Realizimi i shpenzimeve korrente (sipas klasifikimit ekonomik), paraqitet si më poshtë:

	<i>në mijë lekë</i>	<i>në %</i>
- Shpenzimet për paga	44,546	89%
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore	7,258	85%
- Shpenzimet operative	11,346	75%
- Subvencione	712.736	99%
- Transferta për individë	92	30%

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Realizimi sipas produkteve paraqitet:

- Investimet buxhetore për rezultatin A/I: Ujësjiellës i ri

Investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2020 është në vlerën 5,018,657 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese vjetore është realizuar financimi në vlerën 4,860,323 mijë lekë ose në masën rreth 96.8% e planit të akorduar.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/II: Rikonstruksion Ujësjiellësi

Investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2020 është në vlerën 1,525,425 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese vjetore është realizuar financimi në vlerën 1,407,947 mijë lekë, ose në masën e 92% e planit të akorduar.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/III: Kanalizimi i ri

Investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 445,654 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese vjetore është realizuar financimi 436,182 mijë lekë, ose në masën e 97.8 % e planit të akorduar.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/IV:Rikonstruksion KUZ

Investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 197,652 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese vjetore është realizuar financimi 197,652 mijë lekë, ose në masë e 100 % e planit të akorduar.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/V: I.T.U.P

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 163,198 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese vjetore është realizuar financimi 163,192 mijë lekë, ose në masë e 100 % e planit të akorduar.

- Investimet buxhetore për rezultatin A/VI: Konsulencë

Për shërbim konsulence sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 159,010 mijë lekë, në përfundim të periudhës raportuese vjetore është realizuar financimi 157,223 mijë lekë, ose rreth 99% e planit të akorduar.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË HUAJ

- Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/I: Ujësjiellës I ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 2,261,777 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 1,852,176 mijë lekë ose 81% e planit të akorduar.

- Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/II: Kanalizimi i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 1,236,806 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 815,467 mijë lekë ose 65.9% e planit të akorduar.

- Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/III: Impianti i Trajtimit të Ujrave të Zeza

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 144,539 mijë lekë nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 30,868 mijë lekë ose 21% e planit të akorduar.

- Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/IV: Konsulencë

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2020 janë planifikuar 673,630 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 345,853 mijë lekë ose 51 % e planit të akorduar.

Programi “MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE”

Buxheti i shpenzimeve korrente, u planifikua 700 milion lekë dhe realizimi financiar 700 milion lekë ose 100%. Ky zë buxhetor, gjatë vitit 2020 me rishikimet e buxhetit pësoi ndryshime shtesa/pakësime, si më poshtë:

- Akti Normativ nr.6, datë 21.03.2020 "Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2020", shpenzimet korrente u pakësuan me 200 milion lekë;
- Akti Normativ nr.34, datë 16.02.2020, "Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2020", shpenzimet korrente u shtuan me 200 milion lekë.

Shtesat dhe pakësimet e fondeve buxhetore në zërin e shpenzimeve korrente, u reflektuan në projektin "Inceneratori i Tiranës", me autoritet Bashkinë Tiranë.

Buxheti vjetor i rishikuar, për vitin 2020, për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj është 2,953,272,000 lekë dhe realizimi financiar 2,794,979 lekë ose 94.6%.

- Plani i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në vlerën 2,323,272,000 leke dhe realizimi financiar 2,255,811 lekë ose 97% e realizuar.
- Plani i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, në vlerën 630,000,000 lekë dhe realizimi financiar 539,168,000 lekë ose 86% e realizuar.

Buxheti i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, gjatë vitit 2020, me rishikimet e buxhetit u reflektuan ndryshime shtesa/pakësime, si më poshtë:

- Akti Normativ nr.15, datë 15.04.2020 "Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2020", shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u pakësuan me 800,000,000 lekë, konkretisht 552,770,000 lekë për projektin "Iceneratorin e Fierit" dhe 247,230,000 lekë për projektin e "Iceneratorit të Elbasanit".
- Akti Normativ nr.34, datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2020", shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 982,000,000 lekë, konkretisht 247,000,000 lekë për projektin "Iceneratorin e Fierit", 235,000,000 lekë për "Iceneratorin e Elbasanit", 500,000,000 lekë për projektin "Mbyllja e venddepozimit ekzistues ECO Park Durrës".

Gjithashtu, në këtë program buxhetor për vitin 2020, u miratua dhe u zbatua VKM nr.766, datë 30.09.2020 "Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve buxhetore, në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë", fondet buxhetore u shtuan në vlerën 179,000,000 lekë, konkretisht 100,000,000 lekë për projektin "Iceneratori i Fierit" dhe 79,000,000 lekë për "Iceneratorin e Elbasanit".

Në këtë program buxhetor për vitin 2020, janë realizuar projektet si më poshtë:

1. Projekti "Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier", në buxhetin e rishikuar janë planifikuar 755,500,000 lekë dhe realizimi financiar është 752,770,000 lekë ose 99,6% e realizuar.
2. Projekti "Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Elbasan (Inceneratori i Elbasanit)", janë parashikuar 586,770,000 lekë dhe realizimi financiar është 582,720,000 lekë ose 99,3% e realizuar.
3. Projekti "Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë, Faza e dytë", plani është 55,000,000 lekë dhe realizimi financiar 35,911,000 lekë, ose 66 % e realizuar. Problematikë gjatë zbatimit të projektit ka qenë kundërshtimi i ndërtimit të stacionit të transferimit të mbetjeve në Pogradec, nga banorët e zonës. Bashkia Pogradec në bashkëpunim me donatorin (KfW) kanë vendosur që ky stacion, të mos ndërtohet dhe transporti i mbetjeve të bëhet drejtpërdrejtë në landfill. Projekti, ishte parashikuar të përfundonte brenda vitit 2018, por është shtyrë me marrëveshje të nënshkruar midis KfW-së dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë deri në fund të vitit 2020. Nga KfW dhe KRWM është kërkuar shtyrja e këtij projekti edhe për vitin 2021.
4. Projekti "Administrimi i mbetjeve të ngurta në juglindje të Shqipërisë, masa shoqëruese (Faza e II)", plani është 80,000,000 lekë dhe realizimi financiar 6,773,379 lekë ose 9%. Projekti sapo ka nisur të implementohet dhe deri në fund të vitit 2020, nuk janë hasur problematika.

5. Projekti "Ndërtim venddepozitimi i Bushatit (faza II)", është planifikuar 15,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 15,000,000 lekë ose 100% e realizuar. Projekti zbatohet nga Bashkia Vau i Dejës dhe nuk është paraqitur ndonjë problematikë në MIE.
6. Projekti "Punime shtesë të impiantit të trajtimit të ujërave dhe shtresave të landfillit Bajkaj", në vlerën 10,400,000 lekë. Projekti nuk ka pasur realizim financiar, pasi kontrata nga Qarku Vlorë është lidhur në datën 10.12.2020 me operatorin fitues dhe për këtë arsye nuk është bërë e mundur financimi i saj.
7. Projekti "Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit", është planifikuar 140,000,000 lekë dhe realizimi financiar në vlerën 35,426,000 lekë, ose 26% e realizuar. Për zbatimin e këtij projekti është nënshkruar një marrëveshje shtesë dhe pritet disbursimi i projektit.
8. Projekti "Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Vlorës", plani 439,499,000 lekë dhe realizimi financiar 466,691,000 lekë, ose 107% e realizuar. Ky tejkalim plani, ka ardhur nga fondet e planifikuara për financimin e huaj, nga fondet e Kredise.
9. Projekti "Mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta, EKO-Park Durrës", plani 843,400,000 lekë dhe realizimi financiar 835,328,000 lekë, ose 99% e realizuar. Projekti është duke u zbatuar nga AKUM dhe po realizohet sipas kontratës.
10. Projekti "Projekti në fushën e mbetjeve të ngurta financuar në kuadrin e Ekonomisë Cirkulare", plani 11,000,000 lekë. Gjatë vitit 2020, nuk ka pasur realizim financiar, pasi projekti është në fazën e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit me BE-në.
11. Projekti "Ndërtimi i stacioneve të transferimit të mbetjeve sipas parashikimeve të Masterplanit të Mbetjeve", plani 10,000,000 leke. Gjatë vitit 2020, nuk ka patur realizim financiar, pasi projekti është në fazën e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit me KFW-në.
12. Projekti "Projekte për mbështetjen e zbatimit të Masterplanit të Mbetjeve të Ngurta", plani 5,202,000 leke dhe për vitin 2020, nuk ka pasur realizim financiar, pasi projekti është në fazën e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit me KFW-në.
13. Projekti "Ndërtimi i landfillit rajonal Berat dhe masa shoqëruese", plani 10,000,000 lekë dhe për vitin 2020, nuk ka pasur realizim financiar, pasi projekti është në fazën e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit me KFW-në.

Programi "MBËSHTETJE PËR ENERGJINË"

Ky program buxhetor, përgjithësisht mbështet me fonde buxhetore politikat në fushën e energjisë, si atë elektroenergjitike, energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Duke qenë se sektori energjetik është konsideruar si një sektor i një rëndësie të vecantë, janë alokuar nga buxheti fonde për kryerjen në kohë të studimeve dhe opioncave të nevojshme në sektorin energjistik si dhe për krijimin e kushteve të favorshme me synim orientimin e profesionistëve dhe bizneseve drejt zbatimit të politikave për efikasitetin e energjisë në Shqipëri.

Nëpërmjet këtij programi financohen institucionet si Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Eficencës së Energjisë, Agjencia e Energjiave Bërthamore si dhe pagesat e TVSH-ve dhe kostove lokale për projektet me financim të huaj.

Për realizimin e objektivave buxhetore të programit janë planifikuar 44 produkte, një pjesë e të cilave është në proces realizimi ndërsa janë realizuar plotësisht 10 prej tyre, si më poshtë vijon:

- Produkti *“Monitorime në sektorin Energjistik”* i realizuar 100%, ka në përbërjen e tij 2 nënprodukte:
 - Kontrolli i realizimit të investimeve për ndërtimin e HEC-ve me konçension sipas kontratave përkatëse dhe marrja në dorëzim e tyre, sipas programit të zhvillimit të projekteve të vlerësuar nga Oponenca Teknike - Raporte per Oponencen Teknike.
 - Hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standarteve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së - Bilanc Energjetik.
- Produkti *“Studime për përmirësimin e sektorit energjistik, përmirësimin e eficencës së energjisë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme”* ka në përbërjen e tij 14 nënprodukte (studime):
 - Studimi për vlerësimin e eficencës së përdorimit të burimeve energjetike hidrokarbure në sektorin e transportit referuar zhvillimeve teknologjike (ishte Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure) është realizuar në masën 100%.
 - Studimi i plotë i fisibilitetit për vendosjen e Kullave të Karikimit për makinat elektrike në Republikën e Shqipërisë është realizuar në masën 100%.
 - Projekti për mbështetje në sektorin energjetik është realizuar në masën 126%.
 - Projekti LED- Mënyra kryesore për të përmirësuar e eficencën e energjisë në shkollat publike dhe përhapja e përdorimit të shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme është realizuar në masën 149%.
 - Studimi AquaNEX - Ruatja dhe sigurimi i cilësisë të ujërave sipërfaqësor në Shqipëri dhe Greqi duke përdorur teknika të vëzhgimit nga toka është realizuar në masën 382%.
 - Studimi “Mbështetje vazhdimësisë për nismën për transparence në industrinë nxjerrëse EITI” është realizuar në masën 42%.
- Produkti *“TVSH + Kosto Lokale për projektet në fushën e energjisë”*, ka në përbërjen e tij 17 nënprodukte nga të cilat gjatë vitit 2020 janë realizuar pjesërisht 6 prej tyre, si më poshtë:
 - Kosto Lokale për projektin "Rimëkëmbje e sektorit energjistik" është realizuar në masën 90%.

- Kosto Lokale për projektin "Rimëkëmbje e sektorit energjitik" është realizuar në masën 85%.
- TVSh për projektin "Rehabilitimi i Qytetit Studenti Nr.2" është realizuar në masën 83%.
- Kosto Lokale për projektin "Efikasiteti Rajonal i Energjisë" është realizuar në masën 81%.
- TVSH projekti "Gate" është realizuar në masën 72%.
- TVSH "Aqua NEX" Ruatja dhe sigurimi i cilësisë të ujrave sipërfaqësor në Shqipëri dhe Greqi duke përdorur teknika të vëzhgimit nga toka është realizuar në masën 34%.
- Produkti “Ndërtim/Rikonstruksion”, ka në përbërjen e tij 11 nënprodukte nga të cilat gjatë vitit 2020 janë realizuar plotësisht 3 prej tyre dhe pjesërisht 5 prej tyre, si më poshtë:
 - Projekti “Aplikimi i teknikës më të fundit të efijencës së energjisë në godinën e MIE- ish Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës” është realizuar në masën 100%.
 - Projekti "Aplikimi i teknikës më të fundit, të efijencës së energjisë në godinën e MIE (ish Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës - Shtesë Kontrate)" është realizuar në masën 100%.
 - Projekt pilot për sistemin e ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave "2km Smart City - rruga e Energjisë Paster" është realizuar në masën 100%.
 - Kolaudimi "Aplikimi i teknikës më të fundit, të efijencës së energjisë në godinën e MIE- ish Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës" është realizuar në masën 33%.
 - Projektet "Games, Target, Bleu Deal SME.EC dhe Re-Source" është realizuar në masën 24%.
 - "Rehabilitimi i Qytetit të Studenti Nr.2" është realizuar në masën 19%.
 - Projekti "Efikasiteti Rajonal i Energjisë" është realizuar në masën 11%.

Programi “MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE”

Për vitin 2020, objektivat e këtij programi buxhetor janë realizuar në:

- ✓ Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara të mineraleve të kromit, bakrit dhe ranor silicor, vlerësimi sasior dhe cilësor i rezervave minerare, hartimi i studimeve dhe projekteve gjeologjike, studimi dhe vlerësimi i pasurive natyrore të lëndëve hidroenergjetike. Vlerësimin e rreziqeve gjeologjike mbi qëndrueshmërinë e truallit dhe infrastrukturës publike në shkallë vendi dhe vlerësime emergjente. Mirëadministrimi i territorit në shkallë vendi, nëpërmjet përpilimit të hartave gjeologjike, gjeomjedisore gjeomonumenteve.

- ✓ Shfrytëzimi me efikasitet i burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko - profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.
- ✓ Rritja e transparencës në industrinë nxjerrëse, me qëllim rritjen e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse.

Fondet buxhetore të planifikuara në programin "Mbështetje për Burimet Natyrore", përgjithësisht janë fonde buxhetore në mbështetje të politikave në fushën e menaxhimit të burimeve natyrore. Në total, buxheti vjetor i rishikuar për vitin 2020, për programin "Mbështetje për Burimet Natyrore", është 263,778,00 lekë dhe realizimi financiar është 256,262,000 lekë ose 97% e realizuar.

SHPENZIMET KORRENTE

Në këtë program buxhetor, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, fondet për shpenzimet korrente të vitit 2020, janë realizuar si më poshtë:

- Fondi për *paga*, planifikuar 101,970,000 lekë dhe realizimi financiar është 100,712,000 lekë, ose rreth 99%.
- Fondi për *sigurime shoqërore*, planifikuar 17,030,000 lekë dhe realizimi financiar është 16,673,000 lekë, ose 98%.
- Fondi për *shpenzimet operative*, planifikuar 26,990,000 lekë dhe realizimi financiar është 24,353,000 lekë, ose 91%.
- Fondi për *transferrat korrente të huaja*, plani 1,010,000 lekë dhe realizimi financiar është 819,000 lekë, ose 81%.
- Fondi për *transferrat buxhetore për familje e individë*, planifikuar 1,778,000 lekë dhe realizimi financiar 1,284,000 lekë, ose 73%.

SHPENZIMET KAPITALE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Në projektet me financim i brendshëm, janë përfshirë projekte studimore në fushën minerare, të monitorimit të subjekteve minerare të licensuar në fushën e shfrytëzimit mineral, studimeve gjeologjike, gjeofizike, hidrologjike. Këto projekte janë implementuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, dhe ndërmarrjet në konservim Albbakër sh.a, Albkrom sh.a, Albminiera sh.a.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, sipas planit vjetor të rishikuar, janë në vlerën 115,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 112,421,000 lekë, ose 98 % e planit e realizuar.

Objektivat e këtij programi realizohen nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, e cila realizoi zbatimin e 6 projekteve studimore, në vlerën 51,000,000 lekë dhe realizim financiar 48,670,000 lekë ose 95% e planit e realizuar.

Buxheti i vitit 2020, i planifikuar për projektet studimore në fushën e burimeve natyrore, është realizuar 100%, në projektet si vijon :

- Projekti "Përditësim gjeohapsinor i të dhënave të lejeve minerare"
- Projekti "Mbikqyrja e shfrytëzimit të burimeve minerare metalore dhe jometalore"
- Projekti "Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkimet teknologjike e mjedisore"

- Projekti "Studim mbi zonimin minerar dhe hartimi i planit vjetor dhe 3-vjecar minerar"
- Projekti "Raport vjetor mbi gjëndjen mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji"
- Projekti "Monitorimi i fenomeneve të postshfrytëzimit në minierat e mbyllura"
- Projekti "Raport në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri"

Për ndërmarrjet në likujdim "Abminiera", "Albkrom", "Albakër" sh.a, plani i buxheti vjetor të rishikuar për vitin 2020, është 63,040,000 lekë dhe realizimi financiar është 63,040,000 lekë ose 100% e planit e realizuar.

Me buxhetin e rishikuar të vitit 2020, për këto ndërmarrje, u akorduan fonde buxhetore shtesë për vitin 2020, në zbatim të Akteve Normative nr.28, datë 02.07.2020 dhe nr.34, datë 16.12.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2020", ku shoqërive në likujdim, ju akorduan fondet shtesë si më poshtë :

- Albminera 25,920,000 lekë
- Albakër 22,120,000 lekë
- Albkrom 9,960,000 lekë

Programi “MBËSHËTETJE PËR INDUSTRIJË”

Për vitin 2020, objektivat e këtij programi buxhetor janë realizuar në:

- ✓ Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për inspekimin dhe mbikqyrjen, sigurinë në punë dhe për ndërhyrjet e shpëtimit në raste avarish, për monitorimin e inspektimit dhe mbikqyrjes së sigurisë teknike të produkteve/pajisjeve/instalimeve në fushat e veprimtarisë së MIE dhe emergjencat civile.
- ✓ Sigurimi i kushteve të domosdoshme për inspekimin dhe mbikqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.
- ✓ Rritja dhe përmirësimi i standarteve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme në Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme.
- ✓ Sigurimi i kushteve për administrimin e dy landfillet në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme nën administrimin e MIE.
- ✓ Konservimi, likujdimi dhe mbyllja i ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE.
- ✓ Promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e lëkurë këpucës, industrisë së bakrit, nikel silikateve dhe kuarciteve si dhe i disa ish territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

Për realizimin e këtyre objektivave, financohen institucionet si Agjensia Kombëtare për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme (QGTRR) Elbasan dhe ndërmarrjet në konservim si Nërmarrja Azotikut Fier, Prodhim Mobilje Tiranë sh.a, Uzina e Bakrit Rubik, Nërmarrja e Prodhim Çelikut Elbasan, Kombinati Energjistik Elbasan, Prodhim Kablo sh.a Shkodër.

SHPENZIMET KORRENTE

- *Shpenzimet për paga* janë realizuar në masën 99%, ose nga 210,700 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 208,492 mijë lekë.
- *Shpenzimet për Sigurime shoqërore* janë realizuar në masën 98%, ose nga 35,800 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 35,156 mijë lekë.
- *Shpenzimet operative* janë realizuar në masën 99%, ose nga 44,150 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 43,800 mijë lekë.
- *Transferta* është realizuar në masën 98 %, ose nga 966 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 768 mijë lekë.

SHPENZIMET KAPITALE

Analizuar realizim i investimeve sipas produkteve paraqitet si me poshtë:

- “Pajisje dhe aparatura për grupin shpëtim inspektimit” është realizuar në masën 100%.
- “Azotiku Monitorim Landfilli”, është realizuar në masën 100%.
- “Rehabilitim i ish Uzinës së Bakrit Rubik” është realizuar në masën 100%, , pasi është mbajtur sigurim kontrate ne masen 5%.
- “Kolaudim i Punimeve të Rehabilitimit të Uzinës së Bakrit” është realizuar në masën 100%,
- “Blerje paisje kompjuterike dhe sigurim me kamera” është realizuar në masën 12%,Kaq fond është përdoruar për blerjen e pajisjeve.
- “Blerje paisje dedegtuse” nuk është realizuar, nga 1.2milion është bërë rialokim 1milion për arsye mospërdorim fondi.
- “Hapje Pusi Për Furnizim me ujë ”,nuk është realizuar për arsye se kontrata është lidhur me 17.12.2020, por nuk mundi të përfundonte brenda vitit 2020.
- “Konservim Kombinati Energjetik Elbasan”, realizuar 100%.
- “Konservim prodhim Çeliku Elbasan” realizuar 100%.
- “Konservim Azotiku Fier” realizuar 100%,
- “Konservim Prodhim Kabllo Shkodër”, realizuar 100%.
- “Konservim Mobilie sh.a Tiranë” , realizuar 100%.
- “Blerje mjet transporti (Vinç)” me fond 500.000 lekë, nuk është realizuar si rezultat i deshtimit të procedurave të tenderimit.
- “Aparatura Laboratorike për treguesit cilësor të naftës dhe gazit” , është realizuar ne masen 93%.
- “Aparatura për Laboratorin e tekstilit”, është realizuar ne masën 74%, diferenca 856 mije leke, janë diferenca nga tenderimi.
- “Studim ne fushen e Industrie” nuk është realizuar, nga QGTKRR, për mungesë specialistesh dhe konkretisht inxhinier kimist.
- “Studim ne Industrin e Drurit” nuk është realizuar pasi UBT nuk ka realizuar detyrimin kontraktuale për të dorëzuar studimin brenda afateve të përcaktuara në kontratën përkatëse.

- “Buletin Informativ për Industrinë”, nuk është realizuar pasi nuk është marrë përsipër të kryhet nga Universiteti i Tiranës.
- “Blerje mjet transporti (vinç)”, nuk është realizuar.

Programi “PLANIFIKIMI URBAN”

Programi mbështet dhe zbaton procese dhe politika për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban, kontrollin e territorit, mbetjet urbane, si dhe mbështet zhvillimin e vendit në nivel bashkie dhe rajoni.

Politikat e këtij programi synojnë:

- ✓ Planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit në çdo nivel dhe në integrim me çdo sektor;
- ✓ Rigjenerimin urban dhe krijimin e modeleve të reja të zhvillimit të territorit;
- ✓ Hartimin e politikave dhe projekteve në fushën e mbetjeve të ngurta urbane.

SHPENZIMET KORRENTE

Shpenzimet e programit përfshijnë njësi shpenzuese Aparatin e MIE dhe Arkivin Qëndror Teknik të Ndërtimit.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi rezulton:

	<i>në mijë lekë</i>
- Shpenzimet për paga	15,923
- Shpenzimet për sigurimet shoqërore	2,603
- Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	8,036
- Transferta korrente të brendshme	160.000

SHPENZIMET KAPITALE

Sipas zërave përbërës, janë realizuar :

	<i>në mijë lekë</i>
• Financim i brendshëm	73 929
• Financim i huaj	-

INVESTIMET ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Në këtë program u parashikuan në total 78 milion lekë, nga te cilat 6.6 milionë për AQTN-në, dhe rreth 71.4 milionë për projektet që ndjek Aparati i MIE.

Realizimi sipas projekteve:

- Projekti “Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore”, ka përfunduar afati i hartimit sipas kontratave, duke bërë likuidimin sipas fazave, me 38.9 milion lekë ose në masën 97.9%.
- Projekti “Pajisje informatike”, është realizuar 3.7 milion lekë ose në masën 94.3%.

- Projekti “Pajisje për skeleri dhe rafte arkivore”, është realizuar 2.5 milion lekë ose në masën 99.2%.
- Projekti “Projekte pilote për rikualifikimin e blloqeve urbane”, është realizuar 15 milion lekë ose në masën 96.8%.
- Projekti “Përshtatja dhe adaptimi i eurocodeve 5, 9 dhe 6 (pjesa 3) dhe 7 (pjesa 3)”, është realizuar 9.1 milion lekë ose në masën 99.3%.
- Projekti “Hartimin e Anekseve kombëtare të Eurokodeve”, është realizuar 3 milion lekë ose në masën 60%. Për efekt të kohës në zbatimin e kontratës, do të vijohet me përmbylljen në vitin 2021.
- Shpronësimi për projektin “Rikualifikimi Urban Sheshi Borsh”, është realizuar, 743 mijë lekë ose në masën 77.8%.
- Supervizion per rikualifikim e blloqeve urbane, është realizuar 600 mijë lekë ose në masën 75%.
- Kolaudim per rikualifikim e blloqeve urbane, është realizuar 132 mijë lekë ose në masën 91%.

INVESTIMET ME FINANCIM TË HUAJ

Investimet me financim të huaj, për vitin 2020, janë planifikuar rreth 123 milionë lekë dhe nuk ka realizim. Sqarojmë se projekti i GIZ “Lëvizja urbane miqësore ndaj mjedisit në Bashkinë Tiranë”, i përket Bashkisë Tiranë.